



Pranuar me: 27.06.2022			
Nr. Org.	Numër	Shtesa	Vlera
03	2477	1	

**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË
UNIVERSITETIN E PRISHTINËS (për Mësimdhënës / Asistent)**

Fakulteti Fakulteti Filozofik
Pozita Nr. 17

Lëndët Studimet e familjes në perspektivë krahasuese,
Antropologji e gjinisë, Migrimi dhe siguria sociale,
Antropologji urbane, Antropologji e ushqimit,
Veshjet dhe identiteti

Kandidatët e paraqitur 1. Ilirana Blakaj
2. Yllka Sylja - Uka
3. Muhamed Avdullahu

Shënimet për kandidatin e propozuar për angazhim:

Emri dhe mbiemri: Yllka Sylja-Uka
Datëlindja: 02.03.1989
Grada shkencore: MA
Fakulteti/Departamenti: Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe
Studimit të Artit
Universiteti: Qendra e Studimeve Albanologjike
Nostrifikimi i diplomës (për diplomat
e fituara jashtë vendit) 6-4010, 14.11.2017
(Numri i vendimit dhe data)

Titulli aktual akademik: _____
Data kur është fituar titulli aktual: _____

Titulli akademik për të cilin
propozohet kandidati: _____

Komisioni vlerësues:

1. Kryetar/e Prof.Ass.Dr. Tahir Latifi
2. Anëtar/e Prof.Ass.Dr. Arsim Canolli
3. Anëtar/e Ass.Ma. Durim Abdullahu



**SHËNIMET LIDHUR ME AKTIVITETIN ARSIMOR, SHKENCOR DHE
SHËRBYES TË KANDIDATËVE**

Kandidati Nr. 1

Të dhënat për kandidatin:

Emri dhe mbiemri:	Iliriana Blakaj
Datëlindja:	13.04.1995
Grada shkencore:	MA, PhD candidate
Titulli aktual akademik:	
Data kur është fituar titulli aktual:	07.11.2020
Fakulteti/Departamenti:	Social Anthropology
Universiteti:	University of Oxford
Nostrifikimi i diplomës (për diplomat e fituara jashtë vendit)	2/6/2280, 23.06.2022

(Numri i vendimit dhe data)

**SHËNIMET LIDHUR ME AKTIVITETIN ARSIMOR, SHKENCOR DHE
SHËRBYES TË KANDIDATËVE**

Kandidati Nr. 2

Të dhënat për kandidatin:

Emri dhe mbiemri:	Yllka Syla-Uka
Datëlindja:	02.03.1989
Grada shkencore:	MA
Titulli aktual akademik:	
Data kur është fituar titulli aktual:	07.11.2020
Fakulteti/Departamenti:	Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit
Universiteti:	Qendra e Studimeve Albanologjike
Nostrifikimi i diplomës (për diplomat e fituara jashtë vendit)	6-4010, 14.11.2017

(Numri i vendimit dhe data)



Kandidati Nr. 3

Të dhënat për kandidatin:

Emri dhe mbiemri:	Muhamet Avdullahu
Datëlindja:	31.03.1997
Grada shkencore:	MA, PhD kandidat
Titulli aktual akademik:	
Data kur është fituar titulli aktual:	09.10.2020
Fakulteti/Departamenti:	Filozofik/Histori
Universiteti:	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Nostrifikimi i diplomës (për diplomat e fituara jashtë vendit)	

(Numri i vendimit dhe data)

AKTIVITETI ARSIMOR (MËSIMDHËNËS)

Tabela I. 1 Aktivitetet mësimore, me përqendrim te përvoja relevante

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studentëve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies (p.sh., ligjërata, mësim në ekip, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)
Ilirana Blakaj	2022			Trinity semestër - asistente

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studentëve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies (p.sh., ligjërata, mësim në ekip, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)
Yllka Syla - Uka	2018-2022			Asistente e angazhuar

Tabela I. 2 Cilësia në mësimdhënie¹

Aktiviteti	Vlerësimi i aktivitetit
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët etj. (pozitiv/negativ)	

Tabela I. 3 Shpërblime dhe trajnime në mësimdhënie

Shpërblimi/Trajnimi	Data/Periudha	Përshkrimi i shkurtë
Iliriana Blakaj		
Bursë studimore nga MKRS për studime pasuniversitare në	2019-2020	

¹ Fillon të zbatohet nga momenti i sigurimit të sistemit meritot të vlerësimit të studentëve.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK

Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

Universitetin e Oksfordit		
Bursa e dhënë nga Kolegji ISPE për studentë me nderime të larta	2013-2016	
Vlerësim nga Universiteti i Prishtinës për studentë të dalluar	2016	
Mirënjohje nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës për kontribut në realizimin e Projektit të Historisë Gojore "Kujtesa e Kosovës 1: Hisja e Gruas"	2016	
Çmimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës për kontribut në realizimin e Projektit të Historisë Gojore "Kujtesa e Kosovës 2: 100 Pleq e Plaka"	2017	

AKTIVITETI HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

- A. Publikimet në revista ndërkombëtare shkencore në frymën e nenit 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së, në pajtim me Rregulloren Nr. 465 (paragrafi A, shtojca II)

Tabela II. 1 Numri i publikimeve si autor i parë dhe si autor korrespondent

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, Nr., faqet, viti	Linku i indeksimit në Bazat e të dhënave	Koeficienti i barasvlerësi mit
1						

- B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare dhe vendore që nuk janë përfshirë në tabelën paraprake

Tabela II. 2 Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti
	Muhamed Avdullahu	Manifestimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit sipas Historiografisë së vitit 1978	<i>Ars Albanica</i>	5/11, faqe 41-50, 2022

- C. Publikimet e monografive/ librave / kapitujve të librave/ dispensave / përkthimeve në lëmin e kandidatit

Tabela II.3 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj.,

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti
1	Iliriana Blakaj dhe Bjeshka Guri	<i>Katalogu i Andrrave</i>	Libër	2021



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
Raport i Komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm

2	Ilirana Blakaj	<i>Parahistoria</i>	Përkthim	Cuneus, Prishtinë, 2018
3	Iliriana Blakaj	<i>Miti: Një Histori e Shkurtër</i>	Përkthim	Cuneus, Prishtinë, 2017

D. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet

Tabela II. 4 Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet etj.

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Vëllimi, nr., faqet, viti
1				

E. Aktiviteti tjetër kërkimor shkencor

Tabela II. 5 Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar), nga lëmi i kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/Prezantim)	Titulli e prezantimit	Lloji i ligjëratës (Konferencë, Simpozium, Punëtori, Universitet)	Viti, Vendi
1	Yllka Sylja-Uka	Gruaja dhe trashëgimia	Konferencë	2015, Instituti Albanologjik, Prishtinë
2	Yllka Sylja-Uka	E drejta e femrës në trashëgim të tokës. Një vështrim mbi të drejtën ligjore dhe të drejtën kanunore		2014, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/Prezantim)	Titulli e prezantimit	Lloji i ligjëratës (Konferencë, Simpozium, Punëtori, Universitet)	Viti, Vendi
1	Muhamed Avdullahu	Kosova 20 vjet liri dhe përpjekje	Konferencë shkencore organizuar në Fakultetin Filozofik	2020, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës

AKTIVITETI SHËRBYES

Tabela III. 1 Shërbimi në lidhje me Universitetin

Shërbimi përkatësish pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë shërbimit

Tabela III. 2 Shërbimi në lidhje me Komunitetin

Shërbimi përkatësish pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtër shërbimit



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
 Raport i Komisionit Verësues për emërimin, rimerimin dhe avancimin e personelit akademik

SHËNIME PËRMBLEDHËSE TË KANDIDATËVE

Nr.	Emri dhe mbiemri	Grada shkencore	UP	Nr. i lëndëve të ligjëruara Tabela I.1	UNI Tjera	1	5	Nr. i trjanimëve Tabela I.3	Nr. i punimeve në pajtim me paragrafin A Tabela II.1	Tabela II.2	Nr. i punimëve në pajtim me paragr. af. B	Tabela II.3	Nr. i punimëve në pajtim me paragr. af. C	Tabela II.4	Nr. i punimëve/pjesëma rjeve në pajtim me paragr. af. D	Tabela II.5	Nr. i aktivitetëve tjera kërkimore-shkencore, paragrafi E	Nr. i aktivitetëve shërbyese		Mosha (datëlindja)	Përvoja e punës (vitet)	Bie ndesh me Nenin 9, paragrafi 7, Rregullorja Nr. 465 (PO/JO)	
																		Për Universitetin	Për Komunitetin				
1.	Iliriana Blakaj	MA																					
2.	Yllka Sylta-Uka	MA	4																		13.04.1995	1	
3	Muhamet Avdullahu	MA								1											02.03.1989		
																					31.03.1997		

Vërejtje: Nëse kandidati i caktuar nuk i plotëson kushtet minimale të parapara me statutin e UP-së, për të njëjtin mjafton të shënohet kriteri të cilin nuk e plotëson



PROPOZIMI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në rregulloren me nr. prot. 1/95, datë 24.06.2021, si dhe në bazë të kriterëve të parashtruara në konkursin e shpallur me datë 01.06.2022, për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, komisioni ka ndarë mendimin për kandidaten e cila propozohet për pozitën nr. 17.

Fillimisht, komisioni vlerësues në dakordim të plotë, ka menduar se kandidati Muhamet Avdullahu, duke mos i pasur studimet BA dhe Master në Antropologji, aq më tepër për lëndët e shpallura për pozitën nr. 17, nuk i plotëson kriteret për këtë pozitë. Komisioni vlerësues, përkatësisht dy nga tre anëtarët, Tahir Latifi dhe Durim Abdullahu, propozojnë për angazhim kandidaten Yllka Sylja-Uka. Për këtë propozim, diferenca mes dy kandidateve është bërë duke u bazuar në Nenin 7, pika 4.1 të rregullores 1/95, 24.06.2021, që i jep përparësi "kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse".

Ndërsa anëtari tjetër, Arsim Canolli, ndanë mendimin për kandidaten Iliriana Blakaj, për çka ai ka shkruar një propozim të veçantë.

Komisioni vlerësues:

Pozita	Emri dhe mbiemri	Nënshkrimi
Kryetar/e	Prof.Ass.Dr. Tahir Latifi	
Anëtar/e	Prof.Ass.Dr.Arsim Canolli	
Anëtar/e	Ass.MA. Durim Abullahu	

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Fakultetit Filozofik

Si anëtar i Komisionit Vlerësues (vendimi Ref: 2406/01, datë 22.06.2022), për përzgjedhjen e një bashkëpunëtori të jashtëm për ushtrime, sipas pikës 17 të Konkursit (Nr. 1/217), të shpallur më 1 qershor 2022 nga UP, për lëndët: *Studimet e familjes në perspektivë krahasuese, Antropologji e gjinië, Migrimi dhe siguria sociale, Antropologji urbane, Antropologji e ushqimit dhe Veshjet dhe identiteti*, (të gjitha në drejtimin Antropologji kulturore) jap vlerësimin/interpretimin tim individual për kandidatët që kanë aplikuar dhe aplikacionet e të cilëve janë shqyrtuar në takimin e Komisionit Vlerësues më 26 qershor 2022. Ky vlerësim/interpretim jepet për faktin se nuk kemi pasur pajtueshmëri në interpretime. Vlerësimin e jap në bazë të kushteve të konkursit dhe Rregullores për procedura vlerësuese për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, Nr. 1/195 të datës 24.06. 2021.

Vlerësimi im është individual, sepse pas një debatimi bukur të mirë, i njëjti nuk përputhet me vlerësimet e anëtarëve të tjerë të Komisionit Vlerësues.

Pasi si Komision kemi shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve, së bashku, kemi ardhur në këtë konstatim:

1. **Kandidati Muhamed Avdullahu**, nuk ka ofruar dokumentacion se plotëson kushtet për t'u angazhuar si "bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime" për arsye se studimet e tij (BA dhe MA) nuk i takojnë fushës përkatëse (Antropologjisë kulturore). Ai ka specializim në Histori. Shih tabelën më lartë.
2. **Kandidatet Iliriana Blakaj dhe Yilka Syla plotësojnë** kushtet themelore të angazhimit, sipas nenit 7, të cilat janë dhënë në pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3. Ja nenet:
 - 3.1. Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në lëmin përkatës
 - 3.2 Të kenë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dyja nivelet e studimit
 - 3.3 Të jenë jo më të vjetër se 30 vjet [...] kur angazhoihen për herë të parë [...]

Por në bazë të nenit 7, pika 4.1 dhe 4.3, kandidatja Iliriana Blakaj ka "**përvojë më të gjatë në fushën përkatëse**". Ja nenet:

4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotësojnë kriteret e paragrafit 2, përkatësisht 3, të këtij neni, përzgjedhja do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - 4.1. kandidati me përvojë më të gjatë në fushën përkatëse;
 - 4.2 kandidati i gjinisë femërore;
 - 4.3 në rastet tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të cakruar

Duke vlerësuar përvojën më të gjatë në fushën përkatëse, që për mua është fusha e antropologjisë, jo mësimdhënia (shih interpretimin tim të bashkëngjitur), mendoj se kandidatja Iliriana Blakaj ka

afër 8 vite përvojë në kuadër të kohës së projekteve të realizuara, ndërsa kandidatja Yllka Syla ka vetëm 4 vite përvojë në fushën përkatëse, pra mësimdhënie si asistente e angazhuar.

Andaj, duke vërejtur se kandidatja Iliriana Blakaj ka përvojë më të gjatë në fushën përkatëse, ka mbaruar studimet MA me notë të lartë në fushën përkatëse në Universitetin e Oksfordit, ka regjistruar doktoratën në Universitetin e Oksfordit,

Unë propozoj kandidaten Iliriana Blakaj për bashkëpunëtore të jashtme për ushtrimet në lëndët e shpallura me konkurs për pozitën 17.

Më poshtë gjeni arsyetimin e interpretimit tim,

Me respekt

Arsim Canolli

2


Përmbledhje e interpretimit tim mbi nën-paragrafin 4.1 të paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores për procedura vlerësuese për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP, Nr. 1/195 të datës 24.06. 2021

Të nderuar kolegë,

Po ju dërgoj vlerësimin tim për “përvojën më të gjatë në fushën përkatëse” (neni 7, paragrafi 4, nën-paragrafi 4.1), që duket të jetë çështja kryesore për propozimin e kandidatit për vendim në Këshill të Fakultetit, siç kërkohet me rregullore. Them propozimin, sepse siç thuhet në rregullore, Komisioni Vlerësues bart përgjegjësi për vertetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit (neni 6.13), por duhet të bëjë propozimin mbi interpretimin e këtyre të dhënave. Para se të jap mendimin tim për propozimin e kandidatit për bashkëpunëtor të jashtëm në pozitën 17, dua të jap një interpretim për nenin/paragrafin/nënparagrafin e cekur më lart, që të mirëkuptohemi mbi frymën e germën e interpretimit tim.

Në kuadër të Rregullores së lartcekur, neni 7 përmban dispozitat ligjore kryesore për kushtet (apo në disa raste ‘kriteret’) e përgjithshme dhe specifike të angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Në rastin konkret, për angazhimin e ‘bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime’, në kuadër të nenit 7 të Rregullores, aplikohen paragrafët 3 dhe 4. Sidoqoftë, duke punuar në frymën dhe germën e normës universitare (rregulloreve, statutit, vendimeve etj) , për aq sa di e mundem, do të bëj edhe ndonjë zbrërthimëz të caktuar të neneve dhe paragrafëve tjerë të Rregullores në fjalë, por edhe Statutit të Universitetit. Krejt kjo për kthjelltësi më të madhe të interpretimit të paragrafëve 3 dhe 4.

Paragrafët 3 dhe 4 të nenit 7 të Rregullores në fjalë

Sikurse është theksuar në paragrafin 1 të nenit 7, angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitet ‘bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në vazhdimin e kësaj rregulloreje’. Procedurat specifike për bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, pra, përcaktohen me paragrafët 3 dhe 4.

Paragrafi 3 i nenit 7 të Rregullorës, jep kushtet e përgjithshme (ndonëse kjo nuk është e theksuar shprehimisht) për një bashkëpunëtor të jashtëm për ushtrime, të cilat duhet të plotësohen nga cilido kandidat në listën aplikuese. Pra, plotësimi i tyre nuk krijon përparësi. Plotësimi i tyre është domosdoshmëri. *(Ndonëse për këtë është lënë një dalje, sipas paragrafit 6 të nenit 7 të Rregullores, që në rastin konkret, nuk aplikohet).*

Në rastin kur të gjitha kushtet e përgjithshme sipas paragrafit 3 të nenit 7 të Rregullores, plotësohen nga kandidatët, atëherë paraqitet rrethana e aplikimit të paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores.

Paragrafi 4 i nenit 7 të Rregullores, është i aplikueshëm për të gjithë bashkëpunëtorët e jashtëm në Universitet, në rastet kur plotësohen të gjitha kushtet e përgjithshme. Pra, kur të gjitha kushtet e kërkuara në paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores plotësohen nga kandidatët, atëherë paragrafi 4, jep kriteret specifike apo prioritizimin, nëpërmjet të cilave mundësohet të bëhet përzgjedhja e

kandidatit fitues. Në rastin konkret, subjekt i interpretimeve është nën-paragrafi 4.1 i paragrafit 4, të nenit 7 të Rregullores.

Fusha përkatëse - zbërthimza e parë nën-paragrafi 4.1 të nenit 7

Në rastin konkret, duhet të fokusohemi te interpretimi i nën-paragrafit 4.1 të paragrafit 4, të nenit 7 të Rregullores, dhe zbërthimi i asaj se çfarë nënkupton termi 'fusha përkatëse', për të cilën kërkohet përvojë më e gjatë, në rast të paraqitjes së rrethanës të theksuar më lartë.

Meqenëse Rregullorja nuk përmban ndonjë dispozitë sqaruese mbi përkufizimet e përdorura në Rregullore, atëherë për këtë përdoret rrjedha e përdorimit të termeve në Rregullore dhe Statut.

Për zbërthimin e asaj se çfarë nënkupton termi 'fusha përkatëse', fillimisht duhet të theksojmë disa aspekte të përgjithshme.

Termi 'pozita përkatëse' apo pozita e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, e theksuar disa herë në Rregullore është e qartë që është term administrativ/teknik që ndërlidhet me vendin e lirë për të cilin aplikohet. Pra, pozita përkatëse është pozita e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, e cila manifestohet me aktivitetet, konkretisht me aktivitetet mësimor, siç është klasifikuar në nenin 3 të Rregullores.

Termi 'fusha përkatëse' e theksuar në nën-paragrafin 4.1 të paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores, nënkupton se kandidati, në rast të plotësimit të plotë të kushteve të përgjithshme të kërkuara me paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores, duhet të ketë përvojë pune në fushën përkatëse të cilën e mbulon vendi i lirë për të cilin aplikon. Pra, sipas kësaj, 'fusha përkatëse' është fusha e studimit për të cilën ekziston vendi i lirë.

Kjo ndërlidhet edhe me logjikën e përdorimit të termeve në Statutin e Universitetit, ku në paragrafin 5 të nenit 65 theksohet se njësitë akademike (fakultetet), si nëndarje hierarkike, kanë të drejtë të krijojnë, mes tjerash, departamentet që mbulojnë fusha të përgjithshme të shkencës apo arteve. Pra, departamenti mbulon një fushë të caktuar të shkencës. Po ashtu, në nenin 89 të Statutit të Universitetit theksohet se Universiteti ofron programe për studime në fusha të shkencës humane, sociale, drejtësisë, ekonomisë, etj.

Përvoja më e gjatë - zbërthimza e dytë e nën-paragrafit 4.1 të nenit 7

Në rastin konkret, kontesti ekziston te kriteri i përvojës më të gjatë në fushën përkatëse, konkretisht se a duhet të konsiderohet vetëm përvoja e punës në pozitën përkatëse (apo të ngjashme), pra a duhet të ketë qenë patjetër bashkëpunëtor i jashtëm për ushtrime, apo përvoja më e gjatë në fushën e studimit në përgjithësi, pra a mund të jetë hulumtues, kërkues, përkthyes, etj.

Në bazë të asaj çfarë u theksua më lartë, kriteri i vendosur në nën-paragrafin 4.1 të paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores, nënkupton përvojën e punës në fushën përkatëse për të cilën është hapur pozita. Pra, termi 'fushë përkatëse' nuk kufizohet vetëm në aktivitetin mësimor (siç përcaktohen ushtrimet në nenin 3 të Rregullores), por në fushën në tërësi.

Duke e pasë parasysh edhe aspektin gjuhësor dhe gjykimin logjik, aspekt tjetër që duhet të theksohet është se, mbajtja e ushtrimeve nuk është fushë, por aktivitetet. Po ashtu, në rast se termi 'fusha përkatëse' kufizohet vetëm në aktivitetin mësimor apo ushtrimet, atëherë një kandidat me një përvojë të gjatë pune si ligjërues apo hulumtues, mund të mos jetë i pranueshëm si kandidat, pasi që në veprimtarinë e tij shkencore, nuk ka qenë asnjëherë mbajtës i ushtrimeve, si pozitë përkatëse në aktivitetin mësimor. Pra, nën-paragrafi 4.1 i paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores, nuk është dizpozitë përjashtuese.

Një aspekt tjetër: duket se termet 'fusha përkatëse' dhe 'pozita përkatëse' kanë qenë të dalluara apo të ndara edhe nga shkruesi i normës juridike, që në këtë rast është SENATI i UP-së. Në nën-paragrafin 6.2 të paragrafit 6 të nenit 7 të Rregullores (që nuk aplikohet në rastin konkret, sepse thekson " nëse asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson të gjitha kriteret e paragrafit 3 të këtij neni, ", por mund të merret si shembull për ndarjen mes dispozitave), theksohet se në ato raste kur kandidatët nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme të kërkuara me paragrafin 3 të nenit 7, atëherë aplikohen përparësitë përkatëse, ku njëri element është përvoja më e gjatë e punës në 'pozitën përkatëse'. Pra, është shkruesi i normës, vetëm dy paragrafë më tej, e ka ndarë dhe dalluar 'fushën përkatëse' me 'pozitën përkatëse'.

Në fakt, kjo që theksova në paragrafin tim, më lart, është argument forcues edhe për zbërdhimzën e parë edhe për zbërthimzën e dytë të nën-paragrafit 4.1 të paragrafit 4 të nenit 7 të Rregullores në fjalë.

Prandaj, të nderuar kolegë,

Në bazë të të gjitha hollësive që u theksuan më lartë, në rastin e kandidatëve aplikues për pozitën e lirë, përvoja e punës në fushën përkatëse duhet të konsiderohet si te kandidati që më herët ka ushtruar aktivitetin mësimor të ushtrimeve, po ashtu edhe kandidati, i cili ka përvojë të hulumtimit dhe kërkimit në fushën për të cilën është hapur vendi i lirë.

Si anëtar i Komisionit Vlerësues, kam vepruar në bazë të këtij interpretimi të cilin e bëra më lart.

Me respekt

Arsim Canolli



27.06.2022